



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. ____ Prot.

Berat, më ____.____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PROCESVERBALI I ARGUMENTIMIT DHE MIRATIMIT TË SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHE KRITETREVE TË KUALIFIKIMIT.**

I mbajtur sot, më datë ____ .07.2026, nga njësia e prokurimit e ngritur me Urdhërin Nr.22, dt 08.07.2026, dhe 430/7 Prot.

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Materiale Asfaltimi”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

44113100-6 “Materiale asfaltimi”, 44113620-7 “Asfalt”

VLERA E FONDIT LIMIT: 28,333,023 (njëzet e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e njëzet e tre), lek pa t.v.sh, dhe 302.283 Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me VKM Nr. 710 dt 24.11.2021, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Sherbimeve Publike Bashkia Berat ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

a. Formulari i Sigurimit të Ofertës, sipas **Shtojcës 4**;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **shtojcës 9**

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilin është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit sipas shtojcës 9

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit

Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2023, 2024,2025**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se 2 (dyfishi) i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020 ”Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ne te cilin gjejme te percaktuar se: 3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*; Neni 43 pika 1 dhe 2/a e VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar ku percaktohet se: **Pika 1. KËRKESAT PËR KAPACITETET EKONOMIKE DHE FINANCIARE:** *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi derinë 3 (tre) vitet e fundit financiare.* **Pika2:Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:2/a (dyfishin e vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar).** Vendosija e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/A e nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të

kërkohet në Procedurën e Hapur, perkatesisht; **Pika 2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohë: b)** dyfishin e vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; Duke qene se kjo procedurë prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara më parë gjykon se është e përshtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **bilancet vjetore**, për vitet financiare (**2023, 2024,2025**), në përputhje me nenin 41 të Ligjit nr. 10091/2009 ” Për Auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik,** operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose fatura tatimore të shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara, dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore

dhe/ose

- b) Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat,** si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore.

Argumentimi:*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 4 të nenit 40 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri behet me qellim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet përvojës së mëparshme, se zoterojnë kapacitet dhe aftësinë teknike për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.2.Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Fletë analize ose raport testimi të lëshuar nga organe kompetente shtetërore ose private të akredituara, të 6 muajve të fundit lidhur me mallrat objekt prokurimi.

Argumentimi:*Ky kriter u vendos në përputhje me nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e*

Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, ku citohet: ”dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Ne rastin konkret, kemi te bejme me nje kerkese minimale, per nje dokument cilesie per materialet qe autoriteti kontraktor, kerkon te bleje.

Persa me siper kerkohet nje dokument certifikues i cilesise, pra ne perputhje me nenin 77, ligji nr.162, date 23.12.2021. dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike të kërkuara, që kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës, sipas zerave të preventivit, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit, pasi janë lehtësisht të sigurueshme, me kosto të ulët, si dhe plotësueshme nga cdo operator që është në gjendje dhe do të realizojë një furnizim si ai që kerkon objekti të kontrates.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për përmbushjen e objektit të kontratës, duhet të vërtetojë/disponojë që ka të punësuar mesatarisht:

- 5 (Pesë) shofera me leje drejtimi Kategoria C.
- 1 (një) Automaknist.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 9, të DST-ve. Në zbatim të Nenit 82 të LPP, të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit”, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese, si më poshtë për çdo punonjës të vetdeklaruar.

a.kontratë pune e vlefshme.

b.dëshmitë e drejtimit (të vlefshme).

c.dëshmitë e aftësisë profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet kompetente.

ç.librezë pune.

d.Vërtetim nga Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni tatimor.

dh.Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Në rastin kur mjetet disponohen me qera, shoferët nuk do kërkohen në listpagesat e sigurimeve shoqërore.

Kur mjetet janë me qera shoferët mund të kontraktohen nga ofertuesit për të cilët duhet të paraqitet kontratë qeraje e vlefshme.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të ketë staf për realizimin e furnizimit me mallrat e kerkuara për zbatimin e objektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), dëshmitë e aftësisë profesionale (të vlefshme), etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky person përgjegjës është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Stafit teknik i kualifikuar është kërkuar në raport me furnizimin e mallrave që kerkohen të realizohen të cilat janë ndertimore, etj. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

2.3.4 Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të provojnë se janë në gjendje apo kanë të garantuar furnizimin e produkteve të asfaltit, asfaltobeton, binder, bitum, stabilizant, në kushte të tilla duhet të paraqesin dokumentacionin për:

Fabrikë Asfalti në Pronësi :

Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë, të shoqëruar me leje mjedisore të lëshuar nga QKL si më poshtë:

QKL - Fabrike asfalti – Leje Mjedisore tipi B, Kodi:III.1.B., si dhe e pajisur me ISO 9001:2015, mbi çertifikimin e cilësisë së asfaltit nga prodhuesi, si dhe të shoqërohet me Raport Monitorimi nga Organe të akredituara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit.

Fabrikë Asfalti me qera:

Në rastin kur Fabrika/Impianti asfaltit është **me qera** krahas dokumentacionit të pronësisë si më poshtë duhet të paraqitet dhe Kontrata e qerasë e noterizuar, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës.

QKL - Fabrike asfalti – Leje Mjedisore tipi B, Kodi:III.1.B., si dhe e pajisur me ISO 9001:2015, mbi çertifikimin e cilësisë së asfaltit nga prodhuesi, si dhe të shoqërohet me Raport Monitorimi nga Organe të akredituara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit.

Kontratë Noteriale Furnizmi.

Kontrata me furnizuesin duhet të jetë vlefshme për gjithë periudhën e zhvillimit të prokurimit, dhe duhet të jetë e shoqëruar me Fletë analize ose raport testimi të lëshuar nga organe kompetente shtetërore ose private të akredituara, të 6 muajve të fundit lidhur me mallrat objekt prokurimi.

Op ekonomik ofertues duhet të deklarojë se Fabrika/Impianti i Asfaltit duhet të jetë në një distancë jo më të largët se **70 Km nga vendodhja e AK.**

Argumentimi: Bazuar mbi nenin 77 pika 1 të LPP i ndryshuar, neni 40 pika 3 e VKM nr. 285 dt 19.05.2021 i ndryshuar, mbështetur në kërkesat e STASH 660-87 dhe STASH 561-87, duke pasur në konsideratë, se përgatitja e asfaltit realizohet në temperaturën 150 gradë C deri në 170 Gradë C, Fabrika/Impianti i Asfaltit duhet të jetë në një distancë jo më të largët se **70 Km nga vendodhja e AK,** kjo për arsye që të sigurohet se temperatura e domosdoshme për ngjeshjen e asfaltit është jo më pak se 140 grad C, kusht teknik për ngjeshje referuar dhe VKM Nr. 628 dt 15.07.2015 “Për Miratimin e Rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve”, i ndryshuar.

Temperatura e masës së Asfaltobetonit në momentin e shtrimit në rrugë duhet të jetë në kufi 130-150 gradë C në mot të nxehtë, dhe jo më pak se 130 gradë C në kohë të ftohtë. Kur temperatura e mjedisit të jashtëm është jo më pak se 20 gradë C, Asfalti të jetë jo më pak se 140 gradë C. Referuar kohës dhe temperaturave në të cilën do ekzekutohet kjo kontratë kemi të bëjmë me stinë vjeshtë, temperaturat janë në kufij mbi 20 gradë celsius dhe për rrjedhojë ftohja e Asfaltobetonit është me e shpejtë, kërkohet që Fabrika/Impianti i Asfaltit duhet të jetë në një distancë jo më të largët se **70 Km nga vendodhja e AK.**

Me qëllimin për të shmangur problematika të ndryshme, dhe duke pasur në konsideratë faktin që me këtë mall do shtrohen përveçse zona urbane por edhe rurale në zona të thella, ndaj për rrjedhojë largësia e distancave na sjell problematika në lidhje me mallin.

Kërkesa është vendosur bazuar mbi nenin 77 pika 1 të LPP dhe gjithashtu neni 40 pika 3 e VKM nr. 285 dt 19.05.2021 i ndryshuar pasi ben te mundur dhe garanton, perputhshmerine dhe rregullsine e procesit te furnizimit, cilesine e produktit si dhe disponibilitetin te mallit me cilesine e kerkuar, pergjate ekzekutimit te kontrates. Aftësia e operatorëve ekonomikë për të ofruar mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative dhe besueshmërinë për të zbatuar kontratën. neni 77, pika 4, ligji nr.162, date 23.12.2021.Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.Referuar vkm nr.628, datë 15.07.2015 “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve...specifikimet”, midis të tjerave parashikon se: **përzierja e prodhuar duhet zakonisht të transportohet menjëherë në kantierin e ndërtimit.**

Referuar nenit 2 gërma “b” “qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se; “qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mire përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet

procedurale”. mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës.

Kërkesa është vendosur bazuar mbi nenin 77 pika 1 të LPP dhe gjithashtu neni 40 pika 3 e VKM nr. 285 dt 19.05.2021 i ndryshuar, Ligji Nr.10 448, datë 14.7.2011 “ Për lejet e mjedisit”, Ligjit nr.10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, Ligjit Nr. 10431 dt 09.06.2011, “ Për Mbrojtjen e Mjedisit” konkretisht neni 29 “ Lejet e Mjedisit”, neni 44 “ Monitorimi i përpunshmërisë” ku citohet: Operatori i veprimtarive, të përfshira në kategoritë A dhe B, të referuara në nenin 29 të këtij ligji, monitoron shkarkimet e veprimtarisë së tij, në përputhje me dispozitat e legjislacionit për lejet e mjedisit dhe kushtet e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit. 2. Operatori i referuar në pikën 1 të këtij neni monitoron burimet e shkarkimit të veprimtarisë së vet dhe kryen monitorime të tjera, duke përdorur pajisje dhe instrumente të miratuara, përmes procedurës për verifikimin e matjeve, të parashikuara në legjislacionin e posaçëm dhe në pajtim me kushtet e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit, si dhe mban këto pajisje e instrumente në një gjendje të përshtatshme pune. 3. Operatori mund të kryejë monitorimin nëpërmjet pajisjeve dhe instrumenteve të akredituara që ai disponon ose nëpërmjet laboratorëve të specializuar e të akredituar. 4. Rezultatet e vetëmonitorimit u jepen autoriteteve përkatëse në përputhje me legjislacionin për lejet mjedisore dhe me kushtet e përfshira në lejen përkatëse mjedisore.

Pra duke pasur në konsideratë faktin që kemi të bëjme me produkte ndotëse për ambientin është detyrim ligjor i Operatorit Ekonomik ofertues që të monitorojë aktivitetin e tij, ndotjen që shkakton dhe ta deklarojë atë pranë Institucioneve respektive.

2.3.5 Me qëllim realizimin e objektit të kontratës, Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose me qira:

- minimalisht 5 (pesë) kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton.
- minimalisht 2 (dy) kamionçina vetshkarkuese
- minimalisht 1 (një) autobitumatriçe.

Për mjetet që shënohen në regjistrat publikë, kur janë në pronësi duhet të paraqiten si më poshtë:

1. Çertifikatë pronësie të mjetit
2. leje qarkullimi
3. certifikata e kontrollit teknik
4. siguracioni i mjetit
5. certifikata e transportit të mallrave të lëshuar nga bashkia përkatëse.
6. Foto të mjeteve të cilat identifikojnë qartë mjetin.

7. Dokumentat duhet të jenë të vlefshme gjatë kohës së zhvillimit të procedurës.

Ndërsa në rastin kur mjetet janë me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet dhe kontrata e qirasë e noterizuar, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës.

Per mjetet e transportit per mallrat te klasifikuar sipas legjislacionit ne fuqi te rrezikshme (Autobitumatriçe) duhet te paraqesin:

certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).

Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo zhdoganimi dhe fatura tatimore përkatëse.

Për mjetet të marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet dhe kontrat e qirasë e noterizuar, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës.

Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë se mjetet e paraqitura në ofertë nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe do të jenë në dispozicion të objektit që tenderohet. Gjithashtu duhet të deklarojë vendodhjen e tyre me **qëllim verifikimi** nga Autoriteti Kontraktor. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë nga moment i paraqitjes së ofertës deri në përfundimin e kontratës mjetet e deklaruar si më sipër.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 9, të DST-ve. Në zbatim të Nenit 82 të LPP, të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumentave provuese” të cituara si më lart.

Argumentimi:ky kriter u vendos ne perputhje me neni 77, pika 4, ligji nr.162, date 23.12.2020 ‘ Për prokurimin publik’ I ndryshuar, dhe VKm nr. 285 dt 19.05.2021 e ndryshuar, në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e **teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ne rastin konkret jane kerkuar :

- minimalisht 5 (pesë) kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton.
- minimalisht 2 (dy) kamionçina vetshkarkuese.
- minimalisht 1 (një) autobitumatriçe.

Ne referim te:

- llojit te materialit,
- procesit teknik te furnizimit,
- sasise se kerkuar,
- afatit te kerkuar, si dhe mundesise teknike te vendosjes ne veper.
- Levizshmerise se mjeteve te transportit ne rruge dhe rugica, gjeretise se kthesave dhe tonazheve te tyre, veshtiriseve qe mbart terreni.

Sa me siper kemi te bejme me kritere minimale per plotesimin dhe realizimin e kontrates sipas percaktimeve dhe qellimit te saj me zerat si me poshte:

Nr	analize	Emertimi	Njesia	Sasia
1	3.212/a	Stabilizant (Tampon)	m3	701
2	3.969	Bitum M-3 (leng)	kg	13106
3	3.222	Binder me granil guri kave	ton	1470
4	3.224/1	Asfaltobeton guri kave	ton	1410

Sa më siper është marrë parasysh sasitë e kërkuara, si procesit teknik te furnizimit, dhe ai i vendosjes, pasi nuk janë mallra që mund të magazinohen, si dhe nuk janë mallra që mund të rrinë në gjendje magazinimi, nga vet **natyra fizike** e tyre (binder, asfaltobeton), por menjëherë pas procesit të prodhimit ngakohen në mjet, dhe dërgohen në vendin e vendosjes në vepër.

Referuar vkm nr.628, datë 15.07.2015 “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve...specifikimet”, i ndryshuar, midis të tjerave parashikon se: ***...përzierja e prodhuar (binder, asfaltobeton) duhet zakonisht të transportohet menjëherë në kantierin e ndërtimit.*** Sa më siper llogaritja është mbështetur dhe me mundësinë e autoritetit kontraktor për vendosjen në vepër, në sinkronizim me prodhim-furnizim të mallrave binder, asfaltobeton).

Duke marrë në konsideratë faktin që malli objekt prokurimi do shërbejë për shtrimin e segmenteve të ndryshme në zona urbane por edhe rurale të Bashkisë Berat, këto zona/territore/rrugë, kërkojnë paraprakisht një afat kohor të arsyeshëm nga AK për ti mirëmbajtur dhe bërë gati për shtrim asfalti, pasi janë proçese pune që AK i realizon me aftësitë e tij teknike dhe profesionale, burime njerëzore, të cilat ne i disponojmë dhe këtu përmendim: kanale kulluese, vepra arti, shtresa rrugore me çakull, skarifikim dhe ngjeshje me rrul të cilat kërkojnë një kohë të caktuar paraprakisht hedhjes së asfaltit. Gjithashtu duhet të merret në konsideratë dhe fakti që ASHP është ndërmarrje shumë funksionale ndaj është e përqëndruar dhe në veprimtari të tjera.

Nga AK është llogaritur që nisur nga sasia totale e materialeve të asfaltit prej 3861 Ton, afati i kohëzgjatjes së kontratës (2 muaj), të realizohet një furnizim ditor prej 90 ton në ditë me një furnizim prej rreth 5 kamiona në ditë.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata cilësie (të vlefshme) të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA), si më poshtë:

- ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të Cilësisë) ose **ekuivalente të tij.**

Certifikata e mesiperme të jetë në gjuhën shqipe ose Anglisht. *Çertifikata e mesipërme kërkohet të jete e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili Operator Ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatën ISO 9001-2015 sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

Argumentimi: *Kërkesa e mesipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a, nenin 79 të LPP, nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", janë kërkuar këto certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe sistemi i menaxhimit mjedisor . Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) i përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht mallrat që plotësojnë kërkesat e sandarteve të cilësisë..*

Çertifikatat e cilësisë janë bazuar në përputhje me objektin e zbatimit që do të mbikqyret dhe janë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.

2.3.7 Deklaratë nga Operatori ekonomik Fitues ku merr përsipër që të deklaroj se transporti i mallrave objekt prokurimi do realizohet me shpenzimet e veta sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor në përputhje me grafikun e vendosur nga Autoriteti Kontraktor ose sipas kërkesave të AK.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në bazë të nenit 77 pika 1 e Ligjit Nr. 162/2020 “ Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe Neni 40 pika 3 të VKM-së Nr, 285 dt 19.05.2021 i ndryshuar, me anë të cilit AK kërkon të sigurohet lidhur me kapacitetet teknike dhe profesionale të nevojshme që zotrojnë Op ek ofertues për ekzekutimin e objektit të kontratës. Pavarësisht se kemi të bëjmë me Kontratë mallrash, lidhur me natyrën specifike të mallrave që kërkohen, Operatori ek ofertues

duhet të zotrojnë mjetet e kërkura për transportin e mallrave nga pika e prodhimit në Kantier deri në pikën e dorëzimit të mallrave sipas rakordimeve të palëve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi, dhe aftësite teknike profesionale të kritereve për kualifikim nga pika 2.3.2 deri në 2.3.8 janë vendosur nga specialisti i fushës Iris Hoxhallari, si dhe në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do të paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për tu firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik për shpallje dhe botim nga APP.

Njesia e prokurimit

Roland Deda Personi Përgjegjes

Brikena Halitaj Specialiste finance

Iris Hoxhallari Specialist i Fushes

Miratohet

Titullari i Autoritetit Kontraktor

Joana Melengu